



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 15 gusht 2022
Nr. ref.:RK 2039/22

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

rastin nr. KI187/21

Parashtrues

Naim Gashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. nr. 564/2020 të 27 majit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në përbërje:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendës kryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Naim Gashi, nga fshati Sllovi, komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Isa Salihi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 564/2020, të 27 majit 2021 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 5696/17, të 14 majit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 90/10, të 2 gushtit 2017.
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 26 qershor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 21 tetor 2021, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit.
7. Më 25 tetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 11 nëntor 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, dhe kërkoi informata pasuese si dhe dokumente. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën Supreme.
9. Më 23 nëntor 2021, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dërgoi përmes postës elektronike plotësimin e kërkesës si dhe dokumentet e kërkuara.
10. Më 26 maj 2022, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) duke kërkuar që t'i dërgohet dëshmi se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme.
11. Më 30.qershor 2022, Gjykata Themelore dërgoi fletëkthesën si dëshmi për dorëzimin e aktgjykimit të kontestuar.
12. Më 18 korrik 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Nga bazë të shkresave të lëndës, rezulton se më 19 shkurt 2009, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e shitësit dhe personi I.V.K në cilësinë e blerësit, kanë lidhur Kontratën e shitblerjes Vr. nr. 368/2009. Me këtë kontratë shitblerjeje, parashtruesi i kërkesës i ka shitur personit I.V.K., dy ngastra kadastrale, përkatësisht ngastrën kadastrale me numër P-71409077-01949-0, në vendin e quajtur “Kushljina” në sipërfaqe prej 0.35.74 ha dhe ngastrën kadastrale nr. P-71409077-01950-0, në vendin e quajtur “Kushljina” në sipërfaqe prej 0.33.92 ha, për çmimin e kontraktuar prej 15.000 euro, të cilin blerësi duhet ta paguajë në ditën e nënshkrimit të kontratës.

14. Më 4 mars 2010, parashtruesi i kërkesës i dërgoi një letër blerësit I.V.K., duke thënë ndër të tjera:

„Me Kontratën për shitblerjen e paluajtshmërive Vr. nr. 368/2009 prej 24.02.2009 jemi dakorduar për shitjen e pasurisë sime, të dy parceleve kadastrale, nr. 1949-0 në sipërfaqe prej 0.35.74 ha dhe nr. 1950-0 në sipërfaqe prej 0.33.92 ha, që gjinden në ZK Sllovi, e gjithsej bëjnë 0.69.66 ha. Këto dy parcela prej 0.69.66 ha t'i kam shitur dhe ti i ke ble nga unë nga 800 € për 1 ari dhe shndërruar në para bëjnë 55,728.00 €, por ti mi ke paguar vetëm 47,500.00 €, pra me pak për 8,228.00 €.

Çmimi prej 15,000.00 € në Kontratën e cekur është shkruar me insistimin tënd për 1'i ikur taksave më të larta gjyqësore, etj.

[...].“

15. Në bazë të përmbajtjes së shkresave të lëndës, gjykata nuk mund të përcaktojë nëse blerësi I.V.K. i është përgjigjur letrës së parashtruesit të kërkesës.
16. Më 7 prill 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale kundër blerësit I.V.K., në të cilën ai kërkoi ndërprerjen e kontratës për shitblerje Vr. nr. 368/2009, për shkak të “mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale”, si dhe pagesës së kompensimit dhe dëmit në vlerë prej 13,228,00 €.
17. Më 2 gusht 2017, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin C. nr. 90/10, duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar, me të njëjtin aktgjykim Gjykata Themelore urdhëroi të paditurin që paditësi t'ia kompensojë të paditurit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 2.804,00 €.
18. Në arsyetimin e aktgjykimit C. nr. 90/10 të Gjykatës Themelore thuhet; “se në bazë të provave të administruara si më lartë, ka vërtetuar se përmes kontratës së shitëblerjes Vr. 368/2009 datë 24.02.2009, paditësi Naim Gashi i ka shitur paluajtshmëritë e tij në fshatin Sllovi, me çmim të shitblerjes 500 euro për një ari, ndërsa marrëveshja me këtu të paditurin është arritur me datë 18.01.2009, në restorantin 'Standard Benz' afër QMI-së, ku në emër të kaparit paditësi ka pranuar shumën prej 100 euro nga i padituri. Më pas me kërkesën e paditësit me datë 07.02.2009 nga i padituri ka pranuar shumën prej 10000 euro, ndërsa të njëjtën shumë e ka pranuar edhe me datë 25.04.2009, ndërsa këtë fakt gjykata e vërtetoi nga dëshmia e vet paditësit të dhënë në cilësi të palës me datë 11.01.2017. Me tutje ka shtuar se faktin e pakontestueshëm se çmimi i shitblerjes prej 500 euro për ari është vërtetuar nga dëshmitë e të paditurit të dhënë në seancën e datës 12.12.2016, e cila përputhet me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë ...“

Ndërsa faktin tjetër se i padituri në emër të shitëblerjes së ngastrës së paditësit prej 97 ari, ka paguar shumën e tërësishme prej 48500 euro, gjykata e ka vërtetuar përmes administrimit të provave përkatëse, përkatësisht një pjesë e kësaj shume i është paguar bashkëshortes së paditësit përmes llogarisë bankare, por edhe vet pranimit i paditësit, i cili edhe me padi, por edhe në deklaratimet e tij në seancat e mbajtura, ka pranuar faktin se nga i padituri në emër të shitblerjes ka pranuar shumën e cekur më lartë. Si rrjedhojë, kërkesëpadia e paditësit për zgjidhjen e kontratës për shkak të mos përmbushjes dhe kthimin e të drejtës së pronësisë në ngastrat nr. 01949 dhe 01950-o ZK Slllovi, por edhe kompensimin e dëmit, është e pathemeltë, pasi që i padituri e ka përmbushur në tërësi çmimin e shitblerjes, kjo bazuar në nenet 10, 12, 454.1 të LMD-së. Ndërsa, vendimin mbi shpenzimet procedurale e ka mbështetur në nenin 452.1 dhe 463 të LPK-së”.

19. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar, të padrejtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 14 maj 2020, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin Ac. nr. 5696/17 me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke e vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në tërësi.
21. Në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit thuhet;

„Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që ashtu siç e lejon Ligji i Procedurës Kontestimore, gjykata e shkallës së parë, ka marrë nën administrim dhe ka shqyrtuar ato prova të cilat sipas vlerësimit të asaj gjykate, kanë pasur ndikim krucial në zgjidhjen e rastit. Për më tepër, Gjykata e Apelit vlerëson se e tërë struktura e aktgjykimit, është në përputhshmëri me kërkesat e vëna nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së, lidhur me formën dhe përmbajtjen që duhet të kenë pjesët e një aktgjykimi. Në këtë aspekt, dispozitivi i aktgjykimit është mjaft i qartë dhe konkret në atë që është vendosur nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa edhe pjesa arsyetuese përmban arsye të mjaftueshme lidhur me konkluzionin në të cilin ka arritur gjykata e shkallës së parë, lidhur me kontestin në fjalë.

Sa u përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar si duhet gjendjen faktike, edhe ato refuzohen si të pabaza nga kjo Gjykatë e Apelit. Në këtë drejtim, me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, se nuk ka qenë, atëherë me të drejtë ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë, pasi që në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 124 deri 132 të LMDsë që ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes e krijimit të raportit juridik, për zgjidhjen e kontratës së shitblerjes të lidhur në mes palëve kontraktuese, për shkak të mos përmbushjes.”

22. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke theksuar se; “Aktgjykimet e atakuara përmbajnë arsye kontradiktore me përmbajtjen e provave të administruara, se Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së dytë është edhe në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 160 paragrafi 1 pika 1.4 dhe 1.5 të LPK-së, pra gjykata nuk e ka analizuar se nuk ka dhënë vlerësimin dhe arsyetimin, se ka gabuar edhe në zbatimin e së drejtës materiale kur ka konstatuar se ai si paditës duhet të paguajë shpenzimet e procedurës civile në shumën prej 2.804,00 euro”.

23. Më 27 maj 2021, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 564/2020, duke refuzuar si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës të parashtruar kundër Aktgjykimit Ac. nr. 5696/2017 të Gjykatës së Apelit, ku thuhet;

„[...] gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e revizionit të të paditurit se aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 (n) i LPK-së [...]. Sipas vlerësimit të gjykatës, aktgjykimi i kontestuar nuk është përfshirë në shkelje të tilla të procedurës, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe në përputhje me provat e paraqitura, kur gjykata e apelit ka konstatuar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratë për shitblerje me të cilën paditësi e ka shitur pronën e tij të paluajtshme në fshatin Sllovi nga 500 euro për ari ku në emër të kaparit paditësi ka pranuar shumën prej 100 euro nga i padituri. Më pas me kërkesën e paditësit me datë 07.02.2009 nga i padituri ka pranuar shumën prej 10000 euro, ndërsa të njëjtën shumë e ka pranuar edhe me datë 25.04.2009, çmimi i shitblerjes prej 500 euro për ari është vërtetuar nga dëshmitë e të paditurit dhe të dëshmitarëve, A.G., F. G., A. G., dhe S. K.

Fakti se i padituri në emër të shitëblerjes së ngastrës së paditësit prej 97 ari, ka paguar shumën e tërësishme prej 48500 euro, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar përmes administrimit të provave dhe është vlerësuar se një pjesë e kësaj shume i është paguar bashkëshortes së paditësit përmes llogarisë bankare, por edhe vet paditësit, i cili edhe me padi, por edhe në deklaram të tij në seancat e mbajtura, ka pranuar faktin se nga i padituri në emër të shitëblerjes ka pranuar shumën e cekur më lartë“.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimeve të kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
25. Parashtruesi i kërkesës nuk i shpjegon individualisht në kërkesën e tij pretendimet e tij për shkeljen e neneve të përmendura të Kushtetutës, por i shpjegon të gjitha shkeljet e pretenduara në këtë mënyrë:

„[...] gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoj fakti se e tërë kjo kontratë nuk ishte lidhur dhe nënshkruar si puneë e vlefshme juridike, por qëllimi kësaj kontrate ishte diçka tjetër, ishte për të mbuluar një vepër penale [...]. Andaj, qëllimi kësaj kontrate ishte pastrimi i parave, e pastrimi parave është vepër penale e sanksionuar me Kodin penal të Kosovës, pra ishte ndesh me parimet Themelore të Ligjit të Marrëdhënjëve detyimore nenin 1, neni 2, neni 4, neni 35, neni 37, neni 39 par. 2 dhe 4, dhe neni 50, mirpo Gjykata e shkallës së parë nuk e procedoj fare si provë po ashtu as Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, me çka u shkelën të drejtat e palës në procedurën për një gjykim të drejtë dhe të ligjshëm, me çka u shkelën neni 6 i Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtat dhe liritë e njeriut“.

26. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet gjykatës me kërkesën që, „të konstatohet që aktgjykimet e mëparshme janë të kundërligjshme dhe si të tilla të anulohet“.

„Neni 7 [Vlerat]

- 1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*
- 2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.*

“Neni 16 [Epërsia e Kushtetutës]

- 1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.*
- 2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.*
- 3. Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.*
- 4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.”*

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medie, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Dispozitat ligjore

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejshëm LMD) RSEJ i vitit 1978

„Palët në marrëdhëniet e detyrimeve

Neni 10

Palët në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lira, në kufijtë e dispozitave detyruese, rendit publik dhe zakoneve të mira, t'i rregullojnë raportet e tyre në bazë të vullnetit të tyre.

Parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë

Neni 12

Në themelimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit kanë për detyrë t'i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë.

III Zgjidhja e kontratës për shkak të mospërmbushjes

Të drejtat e njëërës palë kur pala tjetër nuk e përmbush detyrimin e vet

Neni 124

Për kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushte parashikuara në nenet e mëpastajmë, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë në qoftë se zgjidhja e kontratës lind sipas vetë të drejtës, e sidoqoftë ka të drejtë t'i kompensohet dëmi.

Kur kontrata nuk mund të zgjidhet

Neni 131

Kontrata nuk mund të zgjidhet për shkak të mospërmbushjes së pjesës së parëndësishme të detyrimit.

Efekti i zgjidhjes

Neni 132

(1) Me zgjidhjen e kontratës të dy palët lirohen nga detyrimet e veta me përjashtim të detyrimit për shpërblimin e dëmit eventual.

(2) Në qoftë se njëra palë ka plotësuar kontratën tërësisht ka të drejtë t'i kthehet ajo që ka dhënë.

(3) Në qoftë se të dy palët kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e asaj që kanë dhënë, kthimet reciproke bëhen sipas rregullave për zbatimin e kontratave dypalëshe.

(4) Secila palë ka detyrime ndaj palës tjetër për dobite që ka pasur në ndërkohë prej asaj që e ka për detyrë ta kthejë ose ta shpërblejë.

(5) Pala që i kthen të hollat ka për detyrë të paguajë kamatëvonesën që nga dita kur e ka marrë pagesën.

Neni 454

(1) Me kontratën e shitjes obligohet shitësi që sendin që e shet ti dorëzojë blerësit kështuqë blerësi të fitojë të drejtën e disponimit, respektivisht të drejtën e pronësisë, ndërsa blerësi obligohet që shitësit ti paguejë çmimin”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“ Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Në vijim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

30. Sa i përket plotësimit të këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili e konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 564/2020 të 27 majit 2021, pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës po ashtu theksoi të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kushtet e nenit 48 të Ligjit dhe e parashtrroi kërkesën e tij në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

31. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (1) (d) dhe (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (1) (d) dhe (2) përcakton që:

*“(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]*

*(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese
[...]*

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

32. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin KI175/20, parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

33. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”;

dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284; shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).

34. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
35. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përmend si arsye kryesore për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë faktin se ai ia kishte shitur dy parcelat e tij blerësit, duke u pajtuar gojarisht se çmimi real i blerjes së 1 (një) ari do të jetë 800 euro, ndërsa në kontratën e shitjes Vr. nr. 368/2009, të cilën ata e kishin lidhur, si çmim të shitblerjes deklarohet shuma prej 500 euro për 1 (një) ari, për arsye se pretendohet që blerësi do të paguante taksë më të ulët me rastin e lidhjes së kontratës. Blerësi i ka paguar parashtruesit të kërkesës tërë çmimin e shitblerjes së kontraktuar prej 500 euro për ari, por jo diferencën ndërmjet çmimit të kontraktuar gojarisht dhe çmimit të deklaruar që ishte në kontratën e shitblerjes, që është një diferencë prej 300 euro për një ari.
36. Duke pasur parasysh këtë, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore duke kërkuar ndërprerjen e kontratës së shitblerjes Vr. nr. 368/2009, për shkak të “mospërmbushjes së detyrimeve të shitblerjes” nga blerësi, si dhe pagesës së kompensimit dhe dëmit, të cilat janë refuzuar nga gjykatat e rregullta. Pikërisht refuzimi i kërkesëpadisë për anulimin e kontratës së shitblerjes Vr. nr. 368/2009, nga gjykatat e rregullta, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ka rezultuar në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 7, 16, 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës.
37. Nga sa më sipër është e qartë se parashtruesi i kërkesës ka pretenduar shkelje të një numri nenesh të Kushtetutës, megjithatë, është gjithashtu e qartë për Gjykatën se ai i arsyeton të gjitha shkeljet e pretenduara të neneve të Kushtetutës vetëm me një paragraf, i cili për nga përmbajtja dhe thelbi shpjegimit të ofruar, mund të cilësohet vetëm si një pretendim në mbështetje të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
38. Rrjedhimisht, Gjykata do të analizojë vetëm pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kontekstin e shkeljeve të mundshme të të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

39. Sa i përket shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës arsyeton shkeljen e pretenduar si në vijim: kontrata e shitblerjes që ka lidhur me blerësin nuk ka qenë transaksion juridik i vlefshëm dhe se në fakt qëllimi i asaj kontrate ka qenë mbulimi i veprës penale të pastrimit të parave, gjë që është në kundërshtim me parimet e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, por Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk e kanë marrë fare parasysh këtë si provë, duke shkelur kështu të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
40. Duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës e ndërlidh shkeljen e pretenduar me procedurat e Gjykatës Themelore, të Apelit dhe të Gjykatës Supreme, është detyrim i kësaj Gjykate që *“t’i shqyrtojë këto procedura në tërësinë e tyre”*, në kontekst të shkeljeve të pretenduara, që është në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) e cila thotë se është *“detyrë e Gjykatës që të shqyrtojë procedurat në tërësi, që në rastin konkret përfshin të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta në një procedurë të vetme”* (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Helmers kundër Suedisë*, e 29 tetorit 1991, kërkesa nr. 11826/85, Seria A nr. 212, fq. 15, paragrafi 31).
41. Duke e shqyrtuar këtë pretendim në kontekstin e procedurës në Gjykatën Themelore, Gjykata konstaton se Gjykata Themelore fillimisht ka përcaktuar në procedurë nëse ka bazë ligjore për anulimin e kontratës së shitblerjes, siç është pretenduar nga parashtruesi në kërkesën e tij.
42. Gjykata konstaton se Gjykata Themelore, duke vlerësuar “mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale”, konstatoi se kërkesëpadia ishte e pabazuar, duke marrë parasysh faktin se blerësi kishte përmbushur çmimin e kontratës nga kontrata e shitblerjes, në të cilën ishte deklaruar si çmim i shitblerjes.
43. Sipas mendimit të kësaj Gjykate, qëndrimi i tillë i Gjykatës Themelore është gjithashtu në pajtim me dispozitat ligjore të cilave u referohet Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj. Më konkretisht, Gjykata konstaton se dispozita ligjore e nenit 10 të LMD-së nuk vendos kufizime në rregullimin e detyrimeve me rastin e krijimit të marrëdhënieve detyrimore, por përkundrazi, neni i përmendur u jep liri palëve kontraktuese që të rregullojnë marrëdhëniet e tyre sipas dëshirës, çfarë kanë bërë blerësi dhe shitësi në këtë dokument të shkruar, përkatësisht kontratën e lidhur për shitblerje. Për më tepër, me rastin e rregullimit të marrëdhënieve juridike, palët janë të detyruara t’u përmbahen parimeve të *“ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë”*, siç përcaktohet me nenin 12 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që në vetvete shpie në përfundimin se palët kontraktuese i janë përmbajtur këtij parimi, kur kanë përcaktuar dhe negociuar çmimin e shitblerjes, të cilin blerësi duhet t’ia paguajë shitësit në bazë të kontratës së shitblerjes.
44. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh se blerësi ia ka paguar çmimin e kontraktuar shitësit, është krijuar obligimi që shitësi t’ia bartë të drejtat pronësore blerësit, siç parashihet me dispozitën ligjore të nenit 454 paragrafi 1 të LMD-së, gjë që ai e ka bërë. Kështu, sipas mendimit të Gjykatës Themelore, palët kontraktuese i kanë kryer obligimet kontraktuale të marra reciprokisht që kanë lindur si pasojë e lidhjes vullnetare të kontratës së shitblerjes. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata Themelore ka konstatuar se baza ligjore e “mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale”, të cilën parashtruesi i kërkesës e ka deklaruar si shkak për anulimin e kontratës së shitblerjes, është e pabazuar.

45. Duke marrë parasysh më tej procedurën gjyqësore të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit në kontekstin e drejtësisë, Gjykata konstaton se thelbi i pretendimeve ankimore kishte të bënte me analizën e provave të paraqitura dhe vërtetimin e gjendjes faktike nga Gjykata Themelore, si dhe hartimin e aktgjykimit të kontestuar.
46. Me këtë rast, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit shqyrtoi pretendimet ankimore parashtruesit të kërkesës, me ç'rast edhe konkludoi i) *se e tërë struktura e aktgjykimit, është në përputhshmëri me kërkesat e vëna nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së, lidhur me formën dhe përmbajtjen që duhet të kenë pjesët e një aktgjykimi. Në këtë aspekt, dispozitivi i aktgjykimit është mjaft i qartë dhe konkret [...]“*, ii) *nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 124 deri 132 të LMD-së që ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes e krijimit të raportit juridik, për zgjidhjen e kontratës së shitblerjes të lidhur në mes palëve kontraktuese, për shkak të mos përmbushjes”*.
47. Bazuar në sa më sipër, vërehet se Gjykata e Apelit e bazoi përfundimin e saj për refuzimin e pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, në faktin se të dyja palët në kontratën e shitblerjes kanë përmbushur plotësisht detyrimet e marra, dhe me këtë, kanë pushuar arsyet që mund të paraqesin bazë ligjore të mjaftueshme për palët kontraktuese që të kërkojnë zgjidhjen e kontratës, siç përcaktohet me nenin 124 të LMD-së, i cili ishte në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës.
48. Përveç kësaj, lidhur me çështjen e drejtësisë së procedurës në Gjykatën Supreme, Gjykata konstaton, ndër të tjera, se Gjykata Supreme ka trajtuar të njëjtin pretendim ankimor të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit, dhe kishte të bënte me çështjen e vërtetimit të gjendjes faktike dhe analizimit të provave të paraqitura në Gjykatën Themelore, të cilat po ashtu u refuzuan nga Gjykata Supreme, duke dhënë një shpjegim të cilin e mbështetë dhe kjo Gjykatë.
49. Për më tepër, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme shkoi një hap më tej duke ofruar një arsyetim në lidhje me pretendimin ankimor të ngritur nga parashtruesi i kërkesës lidhur me pretendimin se çmimi i kontraktuar me gojë për një ari të ngastrës ishte 800 euro dhe jo 500 euro, siç thuhet në kontratën e shitblerjes. Me atë rast, Gjykata Supreme konkludoi:
- “Edhe sikur të vërtetohej nga gjykata e shkallës së parë se me të vërtetë çmimi kontraktues ka qenë 800 euro për ari e jo 500, atëherë serish nuk do të mund të zgjidhej kontrata për shkak të mospërmbushjes dhe atë për shkak se në këtë rast do të kishim mospërmbushje të pjesës së parëndësishme të kontratës, por eventualisht do të kërkohej përmbushja e detyrimit të mbetur nga i padituri (e që në rastin konkret një gjë e tillë nuk është kërkuar). Kjo situatë është e paraparë me nenin 131 të LMD-së, i cili shprehimisht thotë: "Kontrata nuk mund të zgjidhet për shkak të mospërmbushjes së pjesës së parëndësishme të detyrimit”.*
50. Përveç kësaj, duke pasur parasysh pretendimin e parashtruesit të kërkesës se në të vërtetë qëllimi i lidhjes së kësaj kontrate, në të cilën deklarohet një çmim më i ulët, ishte shmangia e pagesës së një tatimi më të lartë me rastin e lidhjes së kontratës, e cila, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, përbën vepër penale, Gjykata nuk do të merret me të për arsye se kjo çështje nuk ka qenë objekt i shqyrtimit dhe gjyqësor dhe vendimmarrjes, dhe në përputhje me këtë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata mund ta konsiderojë këtë pretendim vetëm si një pretendim që hyn në fushën e spekulimeve.
51. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar argumente relevante për të vërtetuar pretendimet e tij se në ndonjë mënyrë ka pasur

shkelje të të drejtave kushtetuese të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në të cilat është thirrur, përveç se është i pakënaqur me rezultatin e procedurës në të cilën janë nxjerrë aktgjykimet e kontestuar.

52. Gjykata rithekson se referimi i thjeshtë në nenet e Kushtetutës dhe KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen *shkelje* të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të ofrojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, KI175/20, Parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, paragrafi 81, KI166/20, Parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale* paragrafi 52, KIO4/21 Parashtrues, *Nexhmije Makolli*, paragrafët 38- 39). Gjykata thekson që është obligim i parashtruesit të kërkesës që t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë provë *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).
53. Prandaj, duke pasur parasysh konstatimet në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata konsideron se këto pretendime kualifikohen si (ii) pretendime që kategorizohen si pretendime me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*". dhe rrjedhimisht Gjykata i hedh poshtë ato si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Pretendimet për shkelje të neneve 7, 16, 24 dhe 46 të Kushtetutës

54. Gjykata gjithashtu rikujton se në kërkesë, parashtruesi i kërkesës pretendoi, ndër të tjera, shkelje të neneve 7, 16, 24 dhe 46 të Kushtetutës, pa shpjeguar dhe arsyetuar se në çfarë baza i ndërton ato shkelje.
55. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) e pretendimeve "*të pambështetura apo të paarsyetuara*" kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vet Gjykata nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 42).
56. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend shkeljet e neneve 7, 16, 24, dhe 46 të Kushtetutës, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te

shkelja e këtyre neneve. Sa i përket këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse të Kushtetutës, por nuk shtjellon më tej se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81, KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52, KI04/21 cituar më lart, paragrafët 38-39).

57. Prandaj, Gjykata konstaton pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 7, 16, 24, dhe 46 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara, pasi këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato janë shkelur.

Përfundim

58. Prandaj, Gjykata konkludon,

a) se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi, pasi këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë së pretendimeve (ii) me “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”;

b) se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 7, 16, 24 dhe 46 të Kushtetutës duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi si pretendime (iii) “*të pambështetura apo të paarsyetuara*.”

59. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (1) (d) dhe paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit, si dhe rregullin 39 1 (d) dhe (2), të Rregullores së punës, më 18 korrik 2022, njëzëri /

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka Nimani